

JU LUTEM

Për informacion të mëtejshëm mbi varfërinë energjitike dhe për të përfituar paketën e ndërhyrjes

Emër Mbiemër

Adresa

Tel/Cel

E-mail

Çfarë do të thotë auditim i energjisë në shtëpi?

- Konsulenti do bëjë një analizë të energjisë dhe ujit të konsumuar në banesën tuaj dhe do t'ju tregojë në cilat mënyra mund të kurseni.
- Konsulenti do t'ju ndihmojë për instalimin e një pakete falas të pajisjeve të kursimit të ujit dhe energjisë.
- Konsulenti do t'ju ofroj udhëzime për të kuptuar faturat e energjisë elektrike, ngrohje dhe ujë.
- Konsulenti do t'ju ofroj këshilla edhe për mirëmbajtjen e pajisjeve, disa sjellje për kursimin e energjisë, etj.
- Konsulenti do t'ju njoh me elementët strukturor-të banesës tuaj (p.sh. izolimi i dobët, sistemi i vjetër i ngrohjes, etj);
- Konsulenti do t'ju jap një udhëzues me këshilla të përgjithshme për të zvogëluar konsumin e energjisë dhe kontaktet nga institucionet që mund t'ju mbështesin në hapat e mëtejshëm.
- Konsulenti do t'ju jap këshilla për efektet shëndetësore.

Të gjitha këshillat dhe ndërhyrjet e konsulentëve dhe pajisjet e kursimit janë **FALAS** për ju; **Konsulentët nuk do të përpiqen t'ju shesin këshillime ose pajisje.**



Projekti EmpowerMed është financuar nga Programi i Bashkimit Evropian për Kërkim dhe Inovacion – Horizon 2020, Kontrata Nr. 847052



EmpowerMed

Përgjithësisht në lidhje me projektin EmpowerMed

Fuqizimi i grave për të ndërmarrë veprime kundër varfërisë energjetike në Mesdhe është një projekt i konsorciumit prej 9 partnerësh dhe MilieuKontakt Shqipëri po e zbaton atë në bashkinë Vlorë në periudhën nga 1 Shtator 2019 deri më 31 Gusht 2023.

EmpowerMed synon të kontribuojë në zbutjen e varfërisë energjetike dhe përmirësimin e shëndetit të njerëzve të prekur nga varfëria energjetike në zonat bregdetare me një fokus të veçantë gratë, përmes masave praktike, të përshtatura për të fuqizuar familjet e prekura nga varfëria e energjisë dhe përzgjedhjes së burimeve të duhura të energjisë.

Varfëri energjetike është situata në të cilën një familje nuk mund të përdorë shërbime energjie në shtepi në një nivel të atillë që të mund të përballojë nevojat sociale dhe materiale.

Inspektim energjetik falas i shtëpisë tuaj nga projekti

Në kuadër të projektit, do të organizohen vizita të këshilltarëve të energjisë në familjet të cilat do të mirëpresin falas ato. Gjatë vizitës, konsulenti do të inspektojë shtëpinë tuaj - nëse keni probleme me humbjen e nxehtësisë me izolim të pamjaftueshëm të detyrës ose dritareve, lagështi ose probleme të tjera, dhe do t'ju ndihmojë të kuptoni faturat tuaja të energjisë dhe ujit - njësi matëse që konsumoni, llogaritje, etj.

Kush mund të përfitojë falas konsultim për energjinë?

Grupe të synuara për projektin janë

- Të moshuarit (pensionistët), kryesisht gra. Gratë janë grupi më i prekshëm dhe më i ekspozuar nga varfëria energjetike edhe nga aspekti shëndetësor.
- Familjet me një prind të vetëm, kryesisht nëna të vetme, beqare.
- Komunitetet etnike (rome, egjiptiane)

Të papunët dhe të punësuarit në rrezik varfërie, kryesisht gra. Të ardhurat e ulëta të tyre nuk mjaftojnë për sigurimin e shërbimeve themelore të energjisë.

Nëse përgjigja për shumicën e deklaratave të mëposhtme është PO, aplikoni për një kontroll energjetik të shtëpisë tuaj

- Nuk e kuptoni faturën e energjisë elektrike, ngrohjes dhe ujit.
- Faturat tuaja të energjisë, gazit dhe ujit duket se janë shumë të larta.
- Në dimër dhe verë, keni probleme me rehatinë në shtëpinë tuaj. Në dimër temperatura e brendshme e shtëpisë është shumë e ulët dhe në verë shumë e lartë, e lagësht ose me myk.
- Keni vështirësi të paguani.

Me parqitjen e formularit të kompletuar të aplikimit, ju pranoi përpunimin e të dhënave tuaja personale (emri dhe mbiemri, nr e personave, adresën e vendbanimit, numrin e telefonit / celularit për kontakt, adresën e e-mail), duke llogaritur nga data e marrjes së formularit të kompletuar të aplikimit, nga MilieuKontakt Shqipëri, Sheshi Avni Rustemi, Pall Teuta Konstruksion, Sh 3 Ap 8 Tiranë, si kordinator i përpunimit, me qëllim të zbatimit të projektit EmpowerMed financuar nga fondet e siguruar nga Programi i Bashkimit Evropian për Kërkim dhe Inovacion – Horizon 2020, Kontrata Nr. 847052, nga 1 shtator 2019 deri me 31 gusht 2023.

Pëlqimi juaj

Ju mund të revokoni (pëlqimin) për përpunim në çdo kohë duke dërguar një kërkesë elektronike tek adresa e-mail: office@milieukontakt.org ose duke dërguar një kërkesë me shkrim në adresën e zyratë. Me shumë informacion mbi zbatimin e përpunimit të të dhënave personale mund të gjenden në faqen e internetit të MilieuKontakt Shqipëri www.milieukontakt.org.






EmpowerMed

Vlorë - Albania

Vlora municipality 5 Administrative units



202,751 inhabitants

616.85 km² surface

71% population lives in urban areas

21.9% unemployed



51%



49%



Vlora municipality

57,260 households

726 receive social assistance

208 women head household

Roma Community

190 families

85% living under minimum


82% live in big families

vulnerable group in energy poverty



Projekti EmpowerMed është financuar nga Programi Bashkimit Evropian për Kërkim dhe Inovacion – Horizon 2020, Kontrata Nr. 847052

EmpowerMed Vlorë - Albania



EmpowerMed



Projekti EmpowerMed është financuar nga Programi Bashkëpunim Evropian për Kërkim dhe